



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:135901

Datë: 13.09.2024

Numri i dokumentit: 06157738

P.nr.71/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sadri Krasniqi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Donjeta Zenuni, në çështjen penale kundër të pandehurit D. Gj., nga ..... për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.626/2024 të datës 24.05.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 22.08.2024, me datë 23.08.2024, publikisht shpalli, ndërsa më datën 13.09.2024 hartoi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri:

**D.G.**, nga babai D. dhe e ëma Zh., i lindur më datë ....., në ....., .me nr.personal ....., serb, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, analfabet, i pa punësuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike – përfitues i ndihmës sociale, sipas evidencës që disponon kjo gjykatë nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

### Ë s h t ë f a j t o r

Më dt.29.04.2024 rreth orës 17.00h, në fshatin Grizime,K.Kamenicë, në ... i pandehuri, me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor, ka ushtruar dhunë në familje duke e lënduar lehtë të dëmtuarin babain e tij D.G., viktimë e ndjeshme, në atë mënyrë që pasi shkon në shtëpi në gjendje të dehur me 0.98%, pa ndonjë arsye fillon të fjaloset me të dëmtuarin

Dobrosav dhe kur i dëmtuari i thotë të ndalej se do ta njoftojë policinë i pandehuri vërsulet në drejtim të dëmtuarin të cilin e godet në pjesën e pasme të shpinës dhe e rrëzon në tokë dhe ashtu të shtrirë në tokë e godet edhe disa her me grushte në pjesën e kokës, me çrast ndërhyjnë mbesat e tij dhe e ndajnë, që si pasojë e goditjeve të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore në formë të gërvishtjes në regjionin e vetullës së majtë të evidentuara me rap. mjekësor nr.12287 i dt.29.04.2024, që sipas ekspertizës mjekoligjore konstatohen si dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-me çka ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 38, 40, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 72, paragrafi 1 pika 1.6 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364 dhe 452, të KPPRK-së, të pandehurin e lartcekur, e

## G J Y K O N

- me dënim **me burgim** në kohëzgjatje prej **120 (njëqind e njëzetë) ditëve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej tetëmbëdhjetë (18) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg efektiv.

- I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit D. G. nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

- Gjykata konfrom nenit 452 par.4 të pandehurin e liron nga pagesa e shpenzimeve të procedurës dhe të njëjtat shpenzime bien në barrën e kësaj gjykate.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, më datën 24.05.2024 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.626/2024, ka kërkuar që ndaj të pandehurit D. G., nga ....., të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se e njëjta është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të pandehurit për datën 22.08.2024. Në të cilën

seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë. Njëherit deklaroi se ka gabuar, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe se i premtonte gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra penale apo të tjera, thekson se veprën penale e ka kryer nën ndikim të alkoolit. Andaj kërkon nga gjykata që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh gjendjen e tij të vështirë ekonomike në të cilën jeton sepse jeton vetëm me babain e tij në një shtëpi të përbashkët dhe se jetojnë vetëm nga ndihma sociale, mundësisht t'i shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit,

Prokurori i shtetit Adnan Hajdari, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, njëherit thekson se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga i pandehurit me veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktit akuzues dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara si në aktin akuzues.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit D.G. deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike dhe me të njëjtin i kanë rregulluar marrëdhëniet dhe prej atij momenti më nuk kanë pasur asnjë mosmarrëveshje ku edhe ai ditën kritike ka përdorur alkool dhe kërkon nga gjykata që djalit tim të tij ti shqiptojë një dënim sa më të butë, pasi që më të njëjtin jetojnë së bashku në kushte të vështira ekonomike.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i pandehuri D.G. me dashje ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të pandehurin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprave penale dhe se për të njëjtin është edhe penalisht përgjegjës.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesve dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga i njëjti, pendimin për kryerjen e veprës penale, po ashtu gjykata pati parasysh edhe gjendjen e tij të vështirë ekonomikes pasi që jeton vetëm me babain e tij dhe vetëm nga ndihma sociale, shih kartelën me nr,10036 e datës 04.01.2023. Gjykata po ashtu ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurit është hera e parë që bien ndesh ligjin, premtimi i tij gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, se tani i rregulluar raportet në mes tyre dhe se nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje tjetër prej rastit të fundit dhe se mosmarrëveshja e fundit ka ardhur si pasojë e konsumimit të alkoolit nga të dyja palët. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj po ashtu edhe relacionin me tani të dëmtuarin e me të cilin është baba e djalë.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj të pandehurit B.K., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit D. G. nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike dhe se thekson që tani me të pandehurin qëndrojnë mirë dhe se prej atij momenti nuk kanë pasur asnjë mosmarrëveshje tjetër dhe se kjo mosmarrëveshje ka rrjedhur si pasojë e përdorimit të alkoolit nga të dyja palët.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, jeton nga ndihma sociale, shih kartelën me nr.10036 e datës 04.01.2023, gjykata konform nenit 452 par.4 të pandehurin e liron nga pagesa e shpenzimeve të procedurës dhe të njëjtat shpenzime bien në barrën e kësaj gjykate.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2024:135901, 13.09.2024**

Zyrtarja Ligjore,

Gjyqtari i vetëm gjykues,

\_\_\_\_\_  
Donjeta Zenuni,d.v.

\_\_\_\_\_  
Sadri Krasniqi,d.v.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë.